

Emri i Lëndës : Media dhe Etika							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 412	B	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Ramadan Cipuri, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Kjo lëndë do të trajtojë aspekte etike të medias. Kursi do të ofrojë një panoramë të shkollave, ideve e pikëpamjeve etike si instrumente analitike për gjykimin e çështjeve të ndryshme, që përftohen nga mënyrat me të cilat mediat e ndryshme pasqyrojnë ngjarjet e ditës. Studentët do kenë mundësi të njihen me modele të gjykimit etik, me raste kombëtare dhe ndërkombëtare për analizë, me rëndësinë e qartësisë e saktësisë, me këndshikimet lidhur me të vërtetën dhe objektivitetin, me jetën private apo dukuritë e shfaqura në kushtet e mediave të reja.					
Objektivat		Përmes orëve mësimore studentëve u jepet një panoramë e zhvillimit historik të etikës, shkollat dhe përfaqësuesit më në zë të saj. Pas prezantimit të koncepteve e termave kyç, fokusi i lëndës përqendrohet në procesin e vetërregullimit të medias në kushtet aktuale. Në lëndë flitet për rolin e medias në shoqëri, raportet me njerëzit e thjeshtë dhe politikën, për rolin e drejtuesve, redaktorëve, burimeve, për kodet etike, ndikimin e teknologjisë dhe mediat e reja. Gjatë orëve shtrohen kazuse nga praktika e medias dhe studentët ftohen të gjykojnë mbi to duke strukturuar arsyetimin e tyre etik. Inskenohen gjithashtu situata konkrete që imponojnë vendimarrjen nga ana e studentëve, të cilët sjellin argumentet e tyre për vendimet e mbi këtë bazë zhvillohet diskutimi në auditor.					
Konceptet Kryesore		1. Etika mediatike 2. Përmbajtje mediatike etike 3. Gjykim etik mediatik 4. Edukim Mediatik 5. Analizë etike					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	1. Hyrje në etikën e medias 1.1. Vendimarrjet dhe dilemat etike 1.2. Dallimi midis etikës dhe moralit						
2	2. Qasjet filozofike mbi etikën e medias 2.1. E mesmja e artë e Aristotelit; 2.2. Urdhri kategorik i Kantit; 2.3. Utilitarizmi; 2.4. Teoria pluraliste e vlerës; 2.5. Komunitarizmi.						
3	3. E vërteta 3.1. Rrezikimi i së vërtetës 3.2. A mund të lejohet gënjeshtria? 3.3. A është i mundur objektiviteti në gazetari? 3.4. Subjektivizmi në etikë						
4	4. Etika, rregullimi dhe vetërregullimi i medias 4.1. Kuadri ligjor i medias shqiptare 4.2. Debatet mbi vetërregullimin e medias 4.3. Përpjekjet për t'u mbështetur në modelet evropiane të vetërregullimit 4.4. Vetërregullimi i medias shqiptare						
5	5. Privatësia, raporti midis ligjit, moralit dhe etikës						
6	6. Etika e mediave digjitale						
7	7. Kodet e etikës në proceset vetërregulluese 7.1. Si t'i kuptojmë kodet e etikës së gazetarit? 7.2. Etika dhe deontologjia e medias 7.3. Hartimi i kodeve etike dhe detyrimet profesionale që burojnë prej tyre						
8	8. Gjuha e urrejtjes, si çështje e nxehtë e debatit etik 8.1. Debatet mbi lirinë e shprehjes 8.2. Gjuha e urrejtjes në mediat tradicionale dhe digjitale 8.3. Angazhimi profesional i gazetarit kundër gjuhës së urrejtjes						
9	9. Programet audiovizive dhe raportimet mbi të miturit dhe grupet e marginalizuara						

10	10. Etika e gazetarit, pronësia e medias dhe vetërregullimi
11	11. Marrëdhënia media – politikë 11.1. Etika në raportimet e lajmeve politike 11.2. Etika e raportimit gjatë fushatave elektorale
12	12. Etika e raportimit në gazetari dhe marrëdhënia me biznesin (PR)
13	13. Etika në raportimin mbi dhunën 13.1. Përshkrimi i dhunës dhe argumentet e kufizimit 13.2. Dilemat e përshkrimit 13.2.1. Seksualiteti 13.2.2. Argumentet konservatore 13.2.3. Argumentet liberale 13.2.4. Argumentet feministë
14	14. Raportimi në momente problematike 14.1. Raportimi në kohë fatkeqësish natyrore 14.2. Raportimi i aksidenteve 14.3. Raportimi në kohë pandemie
15	Fotografia: Etika e fotove dhe videove në gazetari Autoriteti i imazheve Përmbysja e autoritetit të imazheve Stereotipizimi Stereotipizimi: Një çështje morali Logjika e stereotipizimit Imoraliteti i stereotipizimit
16	Final Exam
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• “The Handbook of Mass Media Ethics”, Second Edition, Edited by Lee Wilkins and Clifford G. Christians, Routledge Taylor and Francis Group, 2020 • “Media Ethics: Issues and Cases”, Ninth Edition, Lee Wilkins, Philip Patterson, Chad Painter, The Rowman & Littlefield Publishing Group, Inc., 2019 • Çipuri, Ramadan. 2021. Media përballë pasqyrës. Tiranë: Jupiter Print & Promotion. • Çipuri, Ramadan. 2016. Vetecensura. Tiranë: Papirus.	
Referenca të tjera	
• Sanford, David. 2015. Understanding Media Ethics. Londër: Sage Publications. • McBride, Kelly, dhe Tom Rosenstiel. 2014. The new ethics of journalism. Londër: Sage Publications. • Bertrand, dhe Claude J. a.d. Deontologjia e mediave. Tiranë: Instituti Shqiptar i Mediave. • Ess, Charles. a.d. Etika e mediave digjitale. Përkthyer nga Rrapo Zguri. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias. • Jewkes, Yvonne. 2015. Media & Crime. London: Sage Publications.	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të pajisen me njohuri rreth etikës së medias.
2	Studentët do të studiojnë normat, udhëzimet që menaxhojnë industrinë e medias.
3	Studentët do të jenë në gjendje të diskutojnë në ndërtimin e një industrie mediatike etike dhe profesionale.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	0	0	
Kuize	0	0	
Projekte	1	50	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	30	30
Gjysmë finale	0	0	0
Provimi final	1	30	30
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00